



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Primjena/Prodato Received/Delivery	22-12-2022	viti god year	
Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojcë Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	8380/2022		115



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.944/2022**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar në çështjen administrative sipas ankesës me numër A.nr.944/2022 të datës 25.10.2022 të parashtruar nga ankuesit si në shtojcën nr.1 të këtij vendimi, të cilët me autorizim i përfaqëson

Komuna e Mitrovicës së Jugut, kundër organit të punësimit Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështje juridike " *Kompensim Material*", në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 22.12.2022, njëzëri mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.944/2022 e datës 25.10.2022 e parashtruar nga grup asnkuesish të listuar si në shtojcën nr.1 të këtij vendimi, të cilët me autorizim i përfaqëson nga Mitrovica.**

**A r s y e t i m**

Ankuesit, të listuar si në shtojcën nr.1 të këtij vendimi, që të gjithë të punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre me autorizim

më datë 25.10.2022 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 6438/2022 të regjistruar nën shenjën A.nr.944/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e shujtave ushqimore - ditore sipas Vendimit të datës 02.08.2010 të Kuvendit Komunal të Mitrovicës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datë 09.11.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Mitrovicës së Jugut, ndërsa më datë 02.12.2022, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kryetari i Këshillit, në mbështetje të nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.12.2022 me Vendimin VK.nr.185/2022 ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune për ankesën me numër A.nr.944/2022 të datë 25.10.2022.

Kolegji i Keshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se Kuvendi Komunal i Mitrovicës së Jugut në mbledhjen e mbajtur me datë 02.08.2010 ka miratuar Vendimin për lejimin e mjeteve buxhetore për pagesë të shujtës ditore në vlerë prej pesëdhjetë 50 euro në muaj për shërbyesit civil të administratës së komunës, duke filluar nga data 01.04.2010. Tutje Kolegji i Keshillit ka gjetur se ankuesit përmesë përfaqësuesit të tyre të autorizuar kanë bërë kërkesë në Komunën e Mitrovicës Jugore dhe atë kërkesa e fundit sipas shkresave të lëndës është e datës 24.08.2021 (ankuesit kanë bërë kërkesë veç e veç) përmesë të cilave kërkesa ankuesit kanë kërkuar nga Komuna e Mitrovicës së Jugore, respektivisht Drejtorisë së Financave, Ekonomis dhe Zhvillimit për realizimin e shujtave ushqimore sipas vendimit të Punëdhënësit të datës 02.08.2010.

Rrjedhimisht, Zyrtari i Personelit i Komunës së Mitrovicës Jugut, përmesë e-mailit zyrtar të datës 02.12.2022 me numër protokoll 7606/2022 drejtuar Këshillit ka njoftuar se Komuna e Mitrovicës së Jugut nuk iu ka kthyer asnjëhere përgjigje nëpunësve të cilët kanë kërkuar kompensimin e shujtave ditore.

Ankuesit me bazë të njëjtë ankimore me datë 25.10.2022 kanë parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmerin e ankesës analizoi dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Paroceduren Administrative, i palikueshem në kohen e nxjerrjes se aktit administrativ, përkatësisht nenin 130 ku përcaktohet se: 130.1. *Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin; b) akti është shpallur në bazë të dispozitave të këtij Ligji ose ligjeve të tjera në fuqi.* 130.2. *Në rastin e mosveprimit të administratës (mos nxjerrjes së aktit dhe heshtjes së plotë), ankimi administrativ bëhet brenda 60 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës për fillimin e procedimit administrativ, si dhe dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i aplikueshëm ne kohen e parashtrimit të ankesës në Këshill, përkatësisht nenin 127 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ; 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ, dhe rrjedhimisht duke marr parasysh faktin se ankuesit përmes përfaqësuesit të autorizuar i janë drejtuar me kërkesë organit të punesimit për realizimin e shujtave ditore sipas vendmit të Kuvendit të Komunës dhe atë të datës 02.08.2010, ku në bazë të shkresave të lëndës kërkesa e fundit drejtuar organit të punësimit figuron të jetë e datës 24.08.2021, si dhe duke u bazuar në përgjigjen zyrtare të datës 02.12.2022 me numër protokoll 7606/2022 të organit te punësimit ku konformohet se Komuna e Mitrovicës së Jugut nuk iu ka kthyer asnjëhere përgjigje nëpunësve të cilët kanë kërkuar kompensimin e shujtave ditore, Kolegji i Keshillit konstaton se ankesa A.nr.944/2022 e parashtruar me datë 25.10.2022 është parashtruar jasht afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e nenit 130.2 të Ligjit Nr.02/L-28 për Paroceduren**



Administrative, ashtu sikurse edhe në kundërshtim me dispozitat e ligjit në fuqi, gjegjësisht nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse inicimi i procedimit administrativ konsiderohet se ka filluar me 24.08.2021, veprim ky i fundit sipas shkresave të lëndes kur ankuesit i janë drejtuar organit të punësimit dhe se nga data 24.08.2021 deri me datë 25.10.2022 kur ankuesit i janë drejtuar me ankesë Keshillit, kanë kaluar me tepër se një vit e tre muaj (1.3). Andaj, në këtë kuptim, Kolegji i Keshillit konstaton se ankesa A.nr.944/2022 e datës 25.10.2022 për shkak të parashtrimit jashtë afatit ligjor nuk është e pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 nderlidhur me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Keshtu që duke u bazuar në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Keshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetar i Kolegjit.

**Këshillë Juridike:** Kundër vendimit të Keshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Keshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.Nr.944/2022

**Çlirim ZEKA**

*Çlirim ZEKA*  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar
- Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Mitrovicës së Jugut;
- Arkivit të KPMSHCK-së